



P-V - 5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

KRYETARI

Nr. _____ prot.

Kavajë, më __, __, 2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim dhe miratim

Z. Rudin Hylviu

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIA KAVAJË

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

**"PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS PËR PARANDALIMIN DHE MASAT
QE DUHEN MARRË PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI,
PËR VITIN 2026"**

Me respekt,

KRYETARI

Fisnik Qosja

Mirato:

Florian Merhori: Drejtor i Mjedisit dhe Pyjeve

Albi Lushka: Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit

Helidon Plaku: Drejtor, Drejtorisë Juridike

Punoi:

Florenc Zela, Specialist Pyjesh

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2 (Dy)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2(Dy)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE**

Kavajë, me _____._____.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ Date ____/____/2026

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QE
DUHEN MARRË PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI, PËR
VITIN 2026"**



Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, të ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", të ligjit nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile", të VKM-së nr. 288, datë 27.06.2022 "Për përcaktimin dhe marrjen e masave kundër zjarrit dhe shpëtimin në objekte me rëndësi ekonomike dhe shtetërore", të VKM-së nr. 290, datë 30.04.2004 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Zjarreve në Pyje dhe Kullota", si dhe të VKM-së nr. 835, datë 03.12.2004 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile", është hartuar programi i punës "Për parandalimin dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për periudhën nga muaji qershor deri në fund të vitit 2026".

Referuar pikës 4, germa "c", të nenit 30 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet", ky program duhet të miratohet nga Këshilli Bashkiak brenda muajit mars të çdo viti.

Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Kavajë i propozon Këshillit Bashkiak që, në mbledhjen e tij të radhës:

TË VENDOSË:

1. Të miratojë programin e punës "Për parandalimin dhe masat që duhen marrë për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarri për vitin 2026", i cili ndodhet bashkëlidhur këtij projekt-vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Mjedisit dhe Pyjeve për zbatimin e këtij projekt-vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

Drejtoria e Mjedisit dhe Pyjeve
Florian Merhori

Drejtoria e Burimeve Ekonomike
Albi Lushka

Drejtoria Ligjore
Helidon Plaku

Sekretare e Keshillit Bashkiak
Meri Biturku

KRYETARI I BASHKISË
FISNIK QOSJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin:

RELACION

"PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QE DUHEN MARRË PËR MBROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGA ZJARRI, PËR VITIN 2026

Relatimi i çështjes

Të nderuar këshilltarë !

Bashkia Kavajë paraqet kërkesën për hartimin e këtij programi pune për parandalimin dhe marrjen e masave për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret për vitin 2026. Ky plan menaxhimi hartohet në zbatim të detyrimeve dhe akteve ligjore e nënligjore për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, si dhe për përballimin e situatave emergjente. Miratimi i këtij programi pune për zjarret në pyje dhe kullota ka për qëllim inspektimin, parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, mbrojtjen e jetës së njerëzve, si dhe zvogëlimin e riskut në rastet e shfaqjes së tyre. Origjina e këtyre zjarreve mund të jetë si pasojë e shkaqeve natyrore, ashtu edhe e veprimtarisë njerëzore. Zjarret si fenomen konsiderohen si fatkeqësi natyrore, pasi ndikojnë në jetën e përditshme të njerëzve, në faunë, në pronë dhe në mjedis. Bashkia Kavajë, bazuar në Vendimin nr. 134, datë 03.03.2021, administron 1170.6 ha pyje, 1185.23 ha kullota dhe 98.96 ha sipërfaqe joproductive. E gjithë zona që përfshihet brenda territorit administrativ të bashkisë paraqet rrezik potencial për rënien e zjarreve në pyje dhe kullota. Shuarja e këtyre zjarreve realizohet nën drejtimin e personelit të M.Z.SH.-së Kavajë. Në disa zona me pyje dhe kullota nuk është e mundur ndërhyrja me mjete zjarrfikëse për shkak të terrenit dhe relievit natyror, ndaj ndërhyrja realizohet me forca njerëzore, vullnetarë ose, kur është e mundur, nga ajri. Në rastet kur zjarri është pranë fshatrave, mjetet zjarrfikëse qëndrojnë në gatishmëri pranë banesave. Periudha e rënies së zjarreve në fondin pyjor dhe kullor zakonisht është nga data 15 qershor deri më 15 tetor. Pavarësisht përcaktimit të kësaj periudhe, nuk përjashtohet mundësia e shfaqjes së zjarreve edhe në periudha të tjera, në varësi të kushteve atmosferike dhe ndikimit nga veprimtaria njerëzore. Ndër masat që merren nga Bashkia Kavajë dhe Sektori i Pyjeve për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret janë organizimi i menjëhershëm i personelit pyjor, strukturave të emergjencave civile, njësive administrative, si dhe skuadrave zjarrfikëse vullnetare të ngritura në nivel fshati, të pajisura me mjete të ndryshme, të cilat do të jenë të pranishme në vendngjarje për izolimin dhe shuarjen e zjarreve. Drejtimi i operacioneve për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota fillimisht realizohet nga punonjësit e njësive administrative dhe specialistët e pyjeve, deri në mbërritjen e punonjësve të repartit të M.Z.SH.-së, të cilët marrin drejtimin e plotë të operacionit për shkak të specializimit të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

Bashkia Kavajë dhe Sektori i Pyjeve, pas marrjes së njoftimit për rënien e zjarrit, duke u bazuar në vendndodhjen e tij, përbërjen e masivit pyjor dhe rrezikun ndaj zonave të banuara, përcaktojnë organizimin e shuarjes së zjarrit. Në varësi të përmasave të zjarrit, kërkohet mbështetje me mjete dhe burime njerëzore nga institucione të tjera. Lëvizja e mjeteve dhe burimeve njerëzore drejt vendit ku ka rënë zjarri organizohet nga institucionet përkatëse në rast bashkëpunimi institucional, nga komuniteti vendas në rast angazhimi vullnetar, si dhe nga subjektet private kur bëhet fjalë për prona private. Itinerari i lëvizjes përcaktohet gjithmonë në bazë të konfiguracionit të terrenit. Një masë tj etër që ndihmon në parandalimin e zjarreve në pyje është rehabilitimi i infrastrukturës rrugore në brendësi të fondit pyjor dhe kullësor, kryesisht në zonat pyjore pranë fshatrave. Për këtë qëllim, nga ana e Bashkisë do të vihet në dispozicion të Sektorit të Pyjeve dhe repartit të M.Z.SH.-së mjeti fadromë për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Bashkia Kavajë dhe Sektori i Pyjeve do të zhvillojnë takime sensibilizuese me kryetarët e fshatrave dhe drejtuesit e skuadrave zjarrfikëse vullnetare të ngritura në nivel fshati, në bashkëpunim me strukturat e emergjencave civile dhe M.Z.SH.-në, duke theksuar rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave dhe nevojën për forcimin e masave parandaluese, si dhe reagimin në kohë në rast të rënies së zjarreve. Gjithashtu, do të vendosen postera informues në zonat e banuara, në vende të dukshme, për ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi mbrojtjen e pyjeve nga zjarri. Për sa më sipër dhe në zbatim të akteve ligjore në fuqi, lihet në gjykimin tuaj miratimi i këtij drafti strategjik, i cili paraprakisht është miratuar sipas hierarkisë institucionale nga Bashkia Kavajë.

Shenim :

Arsyet e vonesës për miratim të këtij projekt-vendimi lidhen me mosfunksionimin e dy mbledhjeve të Këshillit Bashkiak gjatë muajve mars dhe prill, rrethanë e cila ka sjellë pamundësinë objektive të shqyrtimit dhe miratimit të tij brenda afatit të përcaktuar në nenin 30, pika c, të Ligjit nr. 57/2020 'Për pyjet', ku parashikohet që plani për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin pyjor kombëtar miratohet brenda muajit mars të çdo viti.

Faleminderit!

Drejtoria e Mjedisit dhe Pyjeve
Florian Merhori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

Nr. 1360/ prot.

Kavajë, më 24. 04. 2026



PROGRAM-PUNE
PER PARANDALIMIN DHE MASAT QE DUHEN MARRE PER
MROJTJEN E PYJEVE DHE KULLOTAVE NGJA ZJARRI
PER VITIN 2026

Ne zbatim te ligjit nr. 139/2015, "Per veteqeverisjen vendore", te ligjit nr.152/2015, "Per sherbimin embrojtje nga zjarri dhe shpetimin", te ligjit nr. 57/2020, "Per Pyjet", ligjit nr. 8756 date 26.03.2001 "Per emergjencat civile", Vendimit te Keshillit te Ministrave nr.288 date 27.06.2002, "Per percaktimin dhe marrjen e masave kunder zjarrit dhe shpetimin ne objektet me rendesi ekonomike dhe shtetere", V.K.M nr. 290 date 30.04.2004, " Per miratimin e Strategjise Kombetare te Menaxhimit te Zjarreve ne Pyje dhe Kullotave", V.K.M nr.835 date 03.12.2004, " Per miratimin e planit kombetar te emergjencave civile", ne Bashkine Kavaje do te merren keto masa organizative:

1. Prane Bashkise Kavaje te ngrihet shtabi I M.N.Z.SH-se I cili te percaktojte masat emergjente qe duhen marre per kete periudhe duke bashkepunuar e bashkevepruar me organet e tjera si dhe Sherbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin. Shtabet e M.N.Z.SH-se te ngrihen e funksionojne edhe ne Njesite Administrative te cilat te hrtojne planin e veprimit perkates.

1 Qershor deri ne fund te vitit 2026

2. Ne baze Njesie Administrative dhe fshati ne funksion dhe te bashkepunimit te perbashket te riorganizohen te gjitha skuadrat e gatishmerise se M.N.Z.SH-se, ne te cilat te marrin pjese perfaqesues te komunitetit me elemente me te perkushtuar, ne krye te te cileve te jene kryetaret e fshatrave dhe inspektorët e zonave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

1 Qershor deri ne fund te vitit 2026

3. Ne pyjet me vlera te vecanta turistike ne zonat bregdetare te merren masa suplementare sherbimi kunder zjarrit, sidomos ne ditet e shtuna dhe te djela, duke disiplinuar levizjane e mjeteve, vizitiroeve dhe pushueseve. Ne vende te dukshme te vendosen tabela te posacme per mbrojtjen nga zjarri.

Maj-Nentor 2026

4. Te vihet ne gadishmeri te plote e gjitha baza material ekzistuese (veglat e punes, fikset, automjetet, etj) per shuarjen e zjarreve ne pyje dhe kullota si dhe sistemi I komunikimit per mbulimin e gjithe territorit te rrethit dhe vecanerisht zonat me rrezikshmeri te larte sic jane pyjet halore.

Gjate gjithe vitit 2026

1. Ne cdo Njesi Administrative te percaktohen pika te perhershme te vrojtim sinjalizimit fikse sipas specifikave dhe per personelin qe sherben ne to te merren masat per komunikim dhe tu percaktohet kohe per raportim te detyrueshem disa here ne dite.

Gjate gjithe vitit 2026

2. Vrojtues-sinjalizuaet e zjarreve qe do te aktivizohen per periudhen Maj-Tetor te merren nga zonat e banuara afer zonave te mbrojtura apo pyjeve me rrezikshmeri te larte zjarri. Krahas vrojtim sinjalizimit te krijohen skuadra te vecanta kunder zjarreve 3-6 veta (te grupuar) per nje veprim te shpejte dhe efektiv.

Maj-Tetor 2026

7 .Nepermjet mjeteve te informimit publik, medias elektronike e te shkruar locale te sensibilizohet opinion I gjere dhe komunitetet locale te sensibilizohet opinion I gjere dhe komunitetet locale per rendesine e madhe te Pyjeve e Kullotave dhe masat mbrojtjes nga zjarri. Puna e sherbimit pyjor te perqendrohet ne masat parandaluese te renies se zjarreve dhe ne kapjen e denoncimin e atyre personave qe vene zjarre me dashje ne pyje dhe kullota.

Gjate gjithe vitit 2026

- 8.Nepermjet mjeteve te informimit public, medias se shkruar dhe asaj elektronike kombetare e locale te organizohen fushata e spote publicitare per sensibilizimin e opinionit public per



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

demet qe shkaktojne zjarret ne pyje dhe nevojne e bashkepunimit e mbeshtetjes se tyre ne procesin e shuarjes se tyre.

Gjate gjithë vitit 2026

9. Fondet e dhena per punime silvikulturale, permisuese dhe mbrojtese, parandaluese per mbrojtjen nga zjarri te pyjeve dhe grumbujve pyjor artificial te kryhen ne zonat me te rrezikuzr dhe me problematike Brenda afateve kohore qe te jene sa me efektive.

Gjate gjithë vitit 2026

10. Mbeshtetur ne V.K.M nr 853 date 03.12.2004 "Per miratimin e planit kombetar te emergjencave civile", per cdo rast zjarri ne pyje dhe kullota dhe sidomos per zjarret me permasa te medha te njoftohen menjehere te gjitha strukturat e tjera vendore e M.N.Z.SH-ja ne qark e n/prefecture duke bashkerenduar punen me keto struktura dhe me ato kufitare.

Vazhdimisht

11. Per ndjekjen hap pas hapi te detyrave te mesiperme ngarkohet Sektori I Pyjeve dhe Kullotave. Per kete te ushtrohen kontrole ne zonat pyjore dhe per te gjitha rastet e renies se zjarreve ne pyje dhe kullota te behen analiza duke marremasat e nevojshme per permiresimin e gjendjes.

Maj-Tetor 2026

12. Shtabi I M.N.Z.SH-se per te ndjekur ne vazhdimesi Planin e Veprimit do te mbidhet cdo 15 dite per te analizuar situaten dhe per rastet emergjente menjehere.

Masat per parandalimin e zjarreve ne pyje/kullota

Te gjitha masat qe merren per parandalimin e zjarreve sipas kohes kur ndermeren dhe me cfare qellimi, ndahen ne:

Masa ligjore mbrojtja e pyjeve/kullotave rregullohet me ligje dhe akte nenligjore ku mbrojtja e tyre eshte pergjegjesi e te gjithëve por edhe e pronareve(bashkise apo subjekteve private) si edhe subjekteve qe I menaxhojne ato.

Masat educative keto jane masa te cilat ne vetevete perfshijne edukimin e njerezve dhe perdoren per te gjitha grupmoshat, megjithse me te perdorurat jane per te rinjte deri ne 18 vjec. Menyrat jane nga me te ndryshmet qe nga mesimet ne libra shkollore, leksione te hapura per mbrojtje e pyjeve nga zjarret, perdorimi I revistave, fletpalosjeve, internet, tv etj..



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

Masa informative-propagandistike, qellimi I tyre eshte per te paralajmeruar dhe informuar njerezit per rreziqet nga paraqitja e zjarreve ne pyje si edhe per te informuar se si duhet te sillemi gjate perdorimit ne pyll. Kjo mase kombinohet edhe me ate educative.

Masa pergatitore

Duke mare parasysh qe masat preventive nuk zgjidhin plotesisht problemin e mbrojtjes se pyjeve nga zjarre, eshte e domosdoshme marrja e masave pergatitore. Keto masa kane nje natyre te perhershme gjate gjithë vitit dhe perfshihen:

Zbulimi ne kohe I zjarrit

Transferimi I informacionit mbi zjarrin

Pergatitja e planit operativ vjetor per mbrojtjen e pyjeve nga zjarret.

Zbulimi ne kohe I zjarrit eshte I nje rendesie te madhe per lokalizimin dhe fikjen shpejt te tij. Ne disa zona kodrinore ka nje dukshmeri te dobet, me qellim qe zjarri tem und te zbulohet ne kohe organizohet sherbimi I monitorimit ne terren nga vezhguesit kundra-zjarr/vrojtueseve kryesisht me patrullim nga toka ne periudhen me te rrezikuar te vitit. E rendesishme per kete faze eshte qe nepermjet institucioneve qendrore (ministri/agjensi etj..) dhe jo vetem te kryhet monitorimi nga ajri. Masa keto te cilat do te mundesojne zbulimin dhe monitorimin e ketyre zjarreve.

Transferimi I informacionit mbi zjarrin e kryer ne menyre te shpejte ka efektin e deshiruar. Dhenia e ketij informacioni behet nepermjet telefonit apo dhe sinjale te tjera si flamuj etj.. Qytetaret te cilet zbulojne zjarre ne pyje e kullota duhet te njoftojne menjehere ne nr e tel 128 Sherbimin e Zjarrefikses. Nje organizim me I mire ne menyraen e transferimit te informacionit do te jete nepermjet radio-lidhese apo ndertimit te rrjetit te marrje-dhenie nepermjet pajisjeve vezhguese ne te gjithë territorin e mbuluar ne pyje.

Organizimi I zjarrefikseve dhe vullnetareve deri tek vatra e zjarrit eshte shume e rendesishme per kete arsye duhet njoftuar menjehere me zbulimin e zjarrit. Transporti I organizuar I zjarrefiksave dhe pajisjeve dhe menyra e organizimit te tyre dhe vullnetare krijon premise per menaxhim te mire te situates se zjarrit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE



Shuarja e zjarrit me uje edhe kjo nje nder metodat tradicionale ne shuarjen e zjarreve. Veprimi I ujit ne procesin e shuarjes eshte I shumefishte.

DREJTORI
Florian Merhori

PER SEKTORIN E PYJEVE DHE KULLOTAVE
Florenc Zela ; Selami Hallulli

KRYETARI I BASHKISE
Fisnik Qosja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

Nr. 1860 prot.

Kavajë, më 17.04.2026

Lënda: MBI NGRITJEN E GRUPIT TE PUNËS PER SHUARJEN E ZJARREVE

NJESISË ADMINISTRATIVE LUZI VOGEL



Mbështetur në ligjin nr 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr 57/2020 "Për Pyjet" si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr 1080, date 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota, si dhe krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve", për ti paraprirë sezonit të nxehtë të verës, ju rikujtojmë se nga ana juaj duhet të ngrihet një grup emergjence për shuarjen e zjarreve, i cili duhet të përbëhet prej tre (3) ose pesë (5) anëtarësh. Ky grup duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkangjitur shkresës po ju dergojmë edhe tabelën që duhet ta sillni të plotësuar për skuadrën vullnetare, përvec kthim përgjigjigjes së shkresës.

Punoi: F.Zela
Miratoi: F.Merhori

Duke ju falenderuar për mirekuptimin.

KRYETARI I BASHKISË
Fisnik Qosja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PËRGJITHSHEM

Adrian Malaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

Nr. 1860 prot.

Kavajë, më 17.04.2026

Lënda: MBI NGRITJEN E GRUPIT TE PUNËS PER SHUARJEN E ZJARREVE

NJESISË ADMINISTRATIVE GOLEM

Mbështetur në ligjin nr 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr 57/2020 "Për Pyjet" si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 1080, date 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota, si dhe krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve", për t'i paraprirë sezonit të nxehtë të verës, ju rikujtojmë se nga ana juaj duhet të ngrihet një grup emergjence për shuarjen e zjarreve, i cili duhet të përbëhet prej tre (3) ose pesë (5) anëtarësh. Ky grup duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkangjitur shkresës po ju dergojmë edhe tabelën që duhet ta sillni të plotësuar për skuadrën vullnetare, përvec kthim përgjigjigjes së shkresës.

Punoi: F. Zela
Miratoi: F. Merhori

Duke ju falenderuar për mirekuptimin.

KRYETARI I BASHKISË
Fisnik Qosja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PERGJITHSHEM
Adrian Malaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

Nr. 1862 prot.

Kavajë, më 17.04.2026

Lënda: MBI NGRITJEN E GRUPIT TE PUNËS PER SHUARJEN E ZJARREVE

NJESISË ADMINISTRATIVE HELMAS



Mbështetur në ligjin nr 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr 57/2020 "Për Pyjet" si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr 1080, date 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota, si dhe krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve", për ti paraprirë sezonit të nxehtë të verës, ju rikujtojmë se nga ana juaj duhet të ngrihet një grup emergjence për shuarjen e zjarreve, i cili duhet të përbëhet prej tre (3) ose pesë (5) anëtarësh. Ky grup duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkangjitur shkresës po ju dergojmë edhe tabelën që duhet ta sillni të plotësuar për skuadrën vullnetare, përvec kthim përgjigjigjes së shkresës.

Punoi: F.Zela
Miratoi: F.Merhori

Duke ju falenderuar për mirekuptimin.

KRYETARI I BASHKISË
Fisnik Qosja

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PERGJITHSHEM

Adrian Malaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
DREJTORIA E MJEDISIT DHE PYJEVE

Nr. 1860 prot.

Kavajë, më 17.04.2026

Lënda: MBI NGRITJEN E GRUPIT TE PUNËS PER SHUARJEN E ZJARREVE

NJESISË ADMINISTRATIVE SYNEJ



Mbështetur në ligjin ne 139/2015 datë 17.12.20215, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr 57/2020 "Për Pyjet" si dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr 1080, date 22.12.2010 "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota, si dhe krijimin e njësive vullnetare të shuarjes se zjarreve", për ti paraprirë sezonit te nxehtë të verës, ju rikujtojmë se nga ana juaj duhet të ngrihet një grup emergjence për shuarjen e zjarreve, i cili duhet të përbëhet prej tre (3) ose pesë (5) anëtarësh. Ky grup duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

Bashkangjitur shkresës po ju dergojmë edhe tabelën që duhet ta sillni të plotesuar për skuadrën vullnetare, përvec kthim përgjigjigjes së shkresës.

Punoi: F.Zela

Miratoi: F.Merhori

Duke ju falenderuar per mirekuptimin.

KRYETARI I BASHKISË

Fisnik Qosja

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETAR I PERGJITHSHEM**

Adrian Malaj

